



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2023:183896

Datë: 14.02.2024

Numri i dokumentit: 05327040

P.2023:183897

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh.H, i akuzuar për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP.nr.1791/22 të datës 28.08.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit të pandehurit të caktuar sipas detyrës zyrtare Avokat Sh.C. për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, më datë 14.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit Xh.H, për hedhjen e aktakuzës si e bazuar.

II. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me numër PP.nr.1791/22 të datës 28.08.2023 dhe pushon procedura ndaj të pandehurit Xh.H, i akuzuar për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së.

III. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP.nr.1791/22 të datës 28.08.2023 kundër të pandehurit Xh.H për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 16.01.2024

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm.

Meqenëse i pandehuri është deklaruar të pafajshëm, gjykata e ka udhëzuar se mund të paraqes kundërshtimet e tijë ndaj provave si dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës duke u bazuar në dispozitat e neneve 243 dhe 244 të KPP-së.

Mbrojtësi i të pandehurit në afatin e paraparë gjyqësor ka paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Gjykata konform nenit 245 të KPP-së, më datë 23.01.2024 i ka dërguar Prokurorisë së Shtetit kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, e njëjta brenda afatit ligjor nuk ka kthyer përgjigje.

Mbrojtësi i të pandehurit, përpos tjerash kërkesën e ka elaboruar si vijon:

- I pandehuri e ka pohuar se ka qenë në kohën në të cilën dyshohet se është kryer vepra penale, por nuk ka pohuar se e ka thyer derën e xhamisë. Pohimi se ka kërkuar peshqir nuk do të thotë se ka thyer ndonjë derë.
- Në aktakuzë mungon përshkrimi detal faktik që ka të bëjë me kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale.
- I pandehuri nuk është parë nga askush, po ashtu nuk është parë as nga përfaqësuesi i xhamisë.

Dhe ka kërkuar nga Gjykata që të hedhet akuza PP.II.nr.1791/22 të datës 28.08.2023, në mungesë të provave për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

*Analizimi dhe vlerësimi i kërkesës*

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me pretendimet e mbrojtësit të pandehurit të paraqitura në kërkesën për hedhjen e aktakuzës i shqyrtoi të gjitha pretendimet e tij dhe shkresat e lëndës, po ashtu analizoi edhe elementet e veprave penale për të cilat akuzohen dhe erdhi në këto përfundime:

**Komform nenit 244 paragrafi 1 pika 1.5 të KPP-së nuk ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet për këto arsye:**

**Gjykata në kuptim të konstatimit të dyshimit të bazuar mirë, i cili është standard ligjor për ngritjen e aktakuzës nga neni 234 paragrafi 1 të KPP-së, i shqyrtoi të gjitha provat në të cilat është e bazuar aktakuza PP.II.nr.1791/22 të datës 28.08.2023 dhe erdhi në përfundim se me asnjë provë të bashkëngjitur në aktakuzë nuk kanë mundur të plotësohet standardi i dyshimit të bazuar mirë që kërkohet për ngritjen e aktakuzës sipas nenit 234 paragrafi 1 të KPP-së për ngritjen e aktakuzës.**

Në aktakuzën PP.II.nr.1791/22 të datës 28.08.2023, mbi bazën e të cilave është ngritur, arsyetuar dhe propozuar që të administrohen si provave janë:

1. Raporti fillestar i incidentit i datës 05.05.2022;
2. Procesverbal i marrjes në pyetje i të pandehurit i dhënë në Stacionin Policor në Kaçanik i datës 16.11.2022.
3. Procesverbal i marrjes në pyetje i të dëmtuarit F.T i dhënë në Stacionin Policor në Kaçanik i datës 11.05.2022.
4. Deklarata e të dëmtuarit F.T i dhënë në Stacionin Policor në Kaçanik i datës 05.05.2022.

5. Tri fletë me fotografi

6. Raport për gjendjen e shëndetit mendor të pandehurin na IPFK me numër 370/2 e datës 22.08.2023

Gjykata ka vlerësuar se në këtë fazë të procedurës kërkesat e parashtruara janë aprovuar sepse në shkresat e lëndës rezulton **se nuk ka prova relevante të cilat prova e lidhin kryesin e veprës penale me veprën penale për të cilën akuzohet.**

I pandehuri edhe pse gjendja mendore e tij për kohën për të cilën është akuzuar në aktakuzë ka qenë në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, i konstatuar në Raport për gjendjen e shëndetit mendor të pandehurin na IPFK me numër 370/2 e datës 22.08.2023, i njëjti në Stacionin Policor në Kaçanik i datës 16.11.2022, nuk e ka pohuar të ketë dëmtuar ndonjë derë të xhamisë, po ashtu i njëjti në asnjë rast nuk ka përmendur as datë dhe as orë se kur ka qenë në xhaminë e fshatit ..., por vetëm ka pohuar se ka qenë në xhami.

Gjykata ka vlerësuar se me anë të kësaj deklarata nuk është arritur që të vërtetohet se ekziston dyshimi i bazuar mirë për ngritjen e aktakuzës i cili është standard ligjor i paraparë në nenin 234 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga Procesverbal i marrjes në pyetje i të dëmtuarit F.T i dhënë në Stacionin Policor në Kaçanik i datës 11.05.2022 dhe nga Deklarata e të dëmtuarit F.T i dhënë në Stacionin Policor në Kaçanik i datës 05.05.2022, i cili në të dy rastet vetëm e ka shpjeguar **se persona të pa njohur** e kanë **dëmtuar derën e zyrës e cila gjendet në katin e dytë**, por asnjëherë nuk ka deklaruar se dikush e ka **dëmtuar derën e hyrjes së xhamisë (siç pretendohet në dsipozitiv të aktakuzës)**, por vetëm të zyrës së tij

Gjykata ka vlerësuar se me anë të këtyre deklaratave nuk është arritur që të vërtetohet se ekziston dyshimi i bazuar mirë për ngritjen e aktakuzës i cili është standard ligjor i paraparë në nenin 234 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga raporti fillestar i incidentit, e po ashtu nga shënimet zyrtare, e po ashtu nga fotografitë e vendit të ngjarjes nuk është konstatuar asnjëherë që pandehuri ta ketë dëmtuar derën e hyrjes së

xhamisë së fshatit Kovaçec dhe nuk është arritur që të bëhet lidhja kauzale shkak pasojë në mes të veprimeve të pandehurit dhe dëmit të shkaktuar.

Po ashtu në aktakuzë nuk është prezantuar asnjë dëshmitar, e po ashtu nuk është prezantuar asnjë dëshmi si video incizime të kamerave nëse ka pasur të tilla.

Gjykata ka vlerësuar se me anë të këtyre deklaratave nuk është arritur që të vërtetohet se ekziston dyshimi i bazuar mirë për ngritjen e aktakuzës i cili është standard ligjor i paraparë në nenin 234 paragrafi 1 të KPP-së.

**Gjykata ka vlerësuar se aktakuza PP.II.nr.1791/22 të datës 28.08.2023 është ngritur nën supozime, e pa bazuar në asnjë provë relevante dhe konkrete.**

Prandaj Gjykata ka vlerësuar se nuk ekziston dyshimi i bazuar mirë, se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe për këtë nuk ka ndonjë provë tjetër të bashkëngjitur në aktakuzë. Prandaj nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme që të procedohet më tutje në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata vlerëson se aktakuza duhet të përcaktoj veprimet e të pandehurit, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale, shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore, dhe në asnjë rrethanë të ngritët aktakuzë nën supozime dhe pa mbështetje në asnjë provë relevante.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale*

Gjykata ka vendosur që të njëjtat bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 453 par 1 të KPP-së.

*Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike*

Duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPPRK-ës, gjykata ka vendosur që palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike ta udhëzoj në kontest civil.

Andaj gjykata duke vepruar konform nenit 243 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPP-së dhe të gjitha arsyeve të cekura më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.2023:183897 datë 14.02.2024

Gjyqtari  
Burim Çaka

KËSHILLË JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 10 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.